



03-859/2012

02

02-03-2012

Nr.regj.37299/11

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Driart Halit Elshani nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 .parg.1,e lidhur me nenin 16 parg.1.2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.**24.02.2012** merrë këtë,

## A K T V E N D I M

**I PANDEHURI:**Driart Halit Elshani i lindur me 14.06.1979 në Prishtinë,ku edhe tani jetonë në Rr"bledit"nr.6/A,i pa maruar,i gjendjes së mesme ekonomike,ka të krye fakultetin,Drejtor i Departamentit për Qeverisje Elektronike pranë Ministrisë së administrates publike.

## Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Drejtor i Departamentit për Qeverisje Elektronike në Ministrinë e Administratës Publike në Prishtinë,i zgjedhur me datën 07.06.2011,nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë i njohtuar se është i përfshirë në Listën e Zyrtarve,të cilet janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë me rastin e marrjes së funksionit. Me veprim të këtillë ka kryer kundërvajtje nga neni 7,parg.1,dhe neni 16 parag.1.2. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

## D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **500 (pesqind )** Euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave Gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, i njëjti do ti zëvendësohet në denim me burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.Në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

## A r s y e t i m

**Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë**,me kërkesën nr.01-4101/11 të parashtruar gjykatës me datën 26.10.2011 për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të permendur me lartë, për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykatë duke vepruar sipas kërkesës, ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në seance verbale ka ndërgjuar të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi: Eshtë e vertet se me dt.07.06.2011 jam zgjedhur Drejtor i departamentit për qeverisje elektronike dhe procese administrative pranë Ministrisë së administrates publike në Qeverinë e Kosovës,si dhe është e vertet se në muajin Tetorë të vitit 2011 e kam deklaruar pasurin,ku gjykatës në afat prej dy ditësh deshminë.

2.

Gjykatësi thirri në cilësinë e deshmitarës Bahrije Hisen Spancës zyrtare e lartë e personelit, e cila në deklaratën e saj thekson: Me përgjegjësi morale dhe materiale deklaroj se Driart Elshanin i zgjedhur Drejtor për qeverisje elektronike pranë Ministrisë së Administratës Publike, e kemi njohtuar dhe i kemi dorëzuar materialin komplet-njohtimin mbi obligimin për deklarimin e pasurisë, ligjin për deklarimin e pasurisë, formularët dhe katalogun e dhuratave. Si deshmi ja prezentoj gjykatës edhe kopjen e shkresave në të cilën është nënshkruar Driart Elshani.

Gjykatësi pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurit, deklaratës së deshmitarës, dhe provave të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresave tjera të lëndës, pastaj edhe faktit se i pandehuri edhe pse i premtoj gjykatës së do të ja siell deshmin mbi deklarimin e pasurisë në afat prej dy ditësh, të cilën gje nuk e beri, gjykatësi erdhi në përfundim se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin shqiptimit dhe caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari vlersoj të gjitha rrethanat nga neni 7 i LMK-së nën të cilat është kryer kundërvajtja, dhe të pandehurit ia shqiptoj kë lloj gjobe duke llogaritur se edhe me këtë lloj denimi do të arrihet efekti i sanksionimit, duke qenë i bindur që i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryej kundërvajtje të këtyllë ose të ngjajshme.

Konform neni 109 al.2 të LMK-së caktohen shpenzimet e procedurës kundërvajtëse.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

Gjyqtari  
Murat Paçarada

